

23/2024

Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

QEVERISJA ME DUAR TË PASTRA DHE HETIMI I KORRUPSIONIT QEVERITAR



Dhjetor, 2024

Autor: Gzim Shalan dhe Florian Smajli

Redaktorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) – Departamentit të Shtetit Amerikan, apo të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



Mbështetur nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Dhjetor, 2024

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	7
2. Dekriminalizimi i politikës.....	8
3. Deputetët dhe qeveritarët që kanë probleme me ligjin.....	10
a. Kuvendi.....	10
b. Qeveria.....	11
4. Qeverisja anti-korrupsion.....	13
5. Mbrojtja qeveritare e të dyshuarve për korrupsion.....	16
a. Rezervat shtetërore.....	16
b. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).....	20
c. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).....	21
d. Dyshimet për kontratat një burimore.....	23
6. Skandalet pa përgjigje.....	24
a. Ndërhyrjet në KEK.....	24
b. Subvencionet.....	25
c. Ambasadori Berishaj.....	27
d. Dyshimet ndaj Faruk Mujkës.....	29
7. Mungesa e shkarkimeve.....	30

1. Përmbledhje ekzekutive

Qeverisja me persona të cilët nuk kanë probleme me ligjin është parim bazë që duhet ndjekur një qeveri e cila synon qeverisjen e mirë. Ky parim nënkupton mos mbajtjen e pozitave publike nga ana e personave të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptim të aktakuzave aktive apo dënime të formës së prerë. Duke njohur dhe kuptuar rëndësinë e parimit të prezumimit të pafajësisë, sidoqoftë integriteti i institucionit dhe zyrtarit publik cenohet kur shfaqen situata ku zyrtarët publik njëren pjesë të ditës e kalojnë në Gjykatë si të akuzuar dhe pjesën tjetër të ditës duke bërë politika publike. Raste të tilla padyshim se cenojnë besimin e publikut në vet institucionet publike. Largimi apo pezullimi i këtyre zyrtarëve është kërkesë e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

Megjithatë, këto situata vazhdojnë të jenë të shfaqura edhe në këtë Qeveri. 7.5% e deputetëve të Kuvendit janë persona të cilët kanë probleme me ligjin derisa në rastin e Qeverisë, kjo përqindje shkon në 37.5%. Këtu bëjnë pjesë edhe rastet e aktakuzave apo dënimeve për vepra penale nga kapitulli i korrupsionit zyrtar.

“Qeverisja anti-korrupsion” tërheq pas vetës nevojën që Qeveria në mënyrë proaktive të promovojë dhe të marrë masa për parandalimin e korrupsionit. Kjo përfshinë raportimin e rasteve të korrupsionit, bashkëpunimin dhe institucionet e sistemit të drejtësisë në rastet e dyshimeve për korrupsion dhe dhënien e përgjegjësisë publike, për aq sa nuk dëmtohet procesin i hetimeve, në rastet kur ngritën dyshime për korrupsion ndaj Qeverisë.

Megjithatë, kështu nuk ndodhi në praktikë. Qeveria ka demonstruar një qasje të kundërt me parimet e qeverisjes së mirë në rastet e dyshimeve për korrupsion ndaj zyrtarëve publikë. Në vend që të promovojë transparencën dhe të bashkëpunojë me institucionet e drejtësisë, Qeveria shpesh ka mbrojtur personat e dyshuar, duke vënë në pikëpyetje punën e institucioneve hetimore dhe duke sulmuar organet e ndjekjes. Kjo mënyrë e veprimit është shpërfaqur në rastin e rezervave shtetërore, dyshimeve për keqpërdorime në KEK, dyshimeve për keqpërdorime në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje: MMPHI), dyshimet në lidhje me kontratat një burimore etj.

Mungesa e llogaridhënies publike për skandalet e ngritura ka dëmtuar parimet e qeverisjes së mirë. Në vend që të ofrohen sqarime të plota dhe transparente për publikun, institucionet shpesh kanë injoruar akuzat ose kanë mbrojtur zyrtarët e përfshirë, duke thelluar mosbesimin ndaj institucioneve shtetërore. Kjo ka ndodhur kështu në rastin e ndërhyrjeve në KEK, rastin e subvencioneve, dyshimeve ndaj ambasadorit Berishaj etj.

Për të ruajtur integritetin institucional dhe besimin e publikut, zyrtarët publikë duhet të bëjnë një hap prapa në rastet e dyshimeve për keqpërdorime. Kjo qasje i mundëson drejtësisë të qartësojë situatën dhe dërgon një mesazh të fuqishëm për përgjegjshmëri, pa paragjykuar fajësinë e zyrtarit

publik. Përkundrazi, kjo qasje dëshmon përkushtim ndaj transparencës dhe integritetit. Nëse kjo nuk ndodhë, atëherë kërkohet ndërmarrja e masave të shkarkimit apo pezullimit varësisht prej pozitës së personit ndaj të cilit kanë filluar procedurat penale, deri në sqarim të plotë të situatës. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur në praktikë. Përballë dyshimeve të shumta të ngritura për keqpërdorime të shumta ndaj akterëve qeveritar, në asnjë rast të njëjtit nuk kanë dhënë dorëheqje apo shkarkuar, duke rrezikuar besimin e publikut në institucionet publike.

2. Dekriminalizimi i politikës

Mbajtja e pozitive të larta publike nga zyrtarë të cilët kanë probleme me ligjin krijon situata kur qytetarët shohin zyrtarët e lartë publikë duke u përballur me drejtësinë dhe duke miratuar politika publike në të njëjtën kohë. Edhe përkundër parimit të prezumimit të pafajësisë, rastet kur zyrtarët e lartë publikë që kanë probleme me ligjin ushtrojnë funksione publike cenon besimin e publikut në integritetin e tyre personal dhe institucional.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (tutje: IKD) për vite me radhë kishte theksuar se është shumë shqetësuese mbajtja e pozitive të larta publike nga ana e personave të cilët kanë probleme me ligjin. Në një raport të publikuar në tetor të vitit 2018, IKD kishte theksuar se “Rastet kur zyrtarët e lartë të shtetit, ditën e punës e fillojnë në gjykatë, në cilësinë e të pandehurit, përpara se të vazhdojnë të qeverisin me vendin, nuk janë të rralla”¹.

Kritikës së IKD i ishte bashkuar edhe Lëvizja Vetëvendosje (tutje: LVV), asokohe parti opozitare, tani partia e cila udhëheq me Qeverinë dhe ka shumicën në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në kritikë ndaj ish-Qeverisë Haradinaj, ish-deputetja e LVV-së, tani Ministre e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, shkruante se “*Kryeministri Haradinaj sot paska thënë se nuk do të shkarkohen ministrat që kanë aktakuza për korrupsion dhe pikërisht sot në mbledhjen e Qeverisë ai përkrahu ndryshimet në Kodin Penal që kanë për qëllim largimin nga postet publike të zyrtarëve që kanë aktakuza për korrupsion! Korrupsioni nuk luftohet kështu. Jo me Qeveri të korrumpuar dhe jo me hipokrizi dhe hedhje hi syve të qytetarëve. Shteti i së drejtës e liberalizimi i vizave bëhet vetëm me njerëz të pa korrumpuar e të ndershëm!*”. Për këtë çështje kishte folur edhe Kryeministri aktual, Albin Kurti, duke theksuar prerazi: “*Jo, nuk do të kemi ministra me aktakuza*”².

¹ “*Dekriminalizimi i Politikës në Kosovë*”. Fq.4. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë. Tetor 2018. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2018/10/1.-Ship-final-Dekriminalizimi-i-Politikes-ne-Kosove-ALB-21.10.2018-1-2.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

² “*Qeverisja me duar të pastërta (Raport mbi deputetët, ministrat dhe kryetarët e komunave të cilët kanë probleme me ligjin)*”. Fq. 6. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë. Dhjetor 2022. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2022/12/Final-Raporti-Qeverisja-me-duar-te-pasterta-2022-1.pdf>); (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

Qeverisja me persona të cilët nuk kanë probleme me ligjin është parim bazë që duhet ndjekur një qeveri e cila synon qeverisjen e mirë. Qeverisja me persona të cilët kanë probleme me ligjin dërgon një sinjal të keq në publik, ku zyrtarë të lartë shtetërorë, të akuzuar për vepra të ndryshme penale, njërën pjesë të ditës e kalojnë në Gjykatë duke u përballë me akuza të ndryshme, përfshirë edhe veprat penale të korrupsionit, derisa pjesën tjetër të ditës e kalojnë duke marrë vendime dhe miratuar politika të cilat proklamojnë avancimin e interesit të qytetarëve. Këto situata paradoksale, e vënë në dyshim besimin e publikut në institucionet qeverisëse. Në anën tjetër, mbajtja e pozitave publike gjatë kohës kur zyrtarët publik kanë probleme me ligjin dërgon një mesazh negativ edhe në raport me gjyqësorin dhe efektin e vendimeve gjyqësore, duke vënë në dyshim, qoftë vetëm si perceptim, pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit në vendimmarrje.

Kjo çështje është trajtuar edhe nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (tutje: UNCAC), e cila ka theksuar obligimin që: Secili shtet palë, në masën që është në pajtim me principet themelore të sistemit të tij ligjor, merr në shqyrtim procedurat nëpërmjet të cilave një nëpunës publik, i akuzuar për një vepër penale të parashikuar sipas kësaj Konvente, nëse është e përshtatshme, mund të largohet, pezullohet ose riemërohet nga organi përkatës, duke pasur parasysh respektimin e principit të prezumimit të pafajësisë³. Po ashtu, kjo Konventë ka përcaktuar edhe dispozita që kërkojnë largimin e personave të dënuar⁴. Edhe përkundër faktit se Kosova nuk është pjesë e kësaj Konvente, kjo nuk e përjashton mundësinë që Kosova të zbatoj parimet dhe standardet që promovon kjo Konventë.

Kështu, siç e ka thënë edhe IKD në raportin e kaluar në lidhje me qeverisjen me duar të pastërta⁵, mos mbajtja e posteve publike nga një person i akuzuar nuk nënkupton fajësinë e atij personi. Në secilin rast, parimi i prezumimit të pafajësisë garanton pafajësi për secilin person deri në momentin e nxjerrjes së një vendimi të formës së prerë që dëshmon fajësinë e të njëjtit. Megjithatë, udhëheqja e institucioneve të ndryshme nga persona të cilët kanë probleme me ligjin në kuptim të dënimeve të formës së prerë apo edhe aktakuzave aktive e zbeh besimin e publikut në këto institucione dhe besimin e publikut në drejtshmërinë e proceseve gjyqësore ndaj këtyre zyrtarëve. Për këtë arsye, kriminalizimi i politikës në kuptim të mbajtjes së pozitave të rëndësishme shtetërore nga zyrtarë që kanë probleme me ligjin nuk është në linjë me parimet e qeverisjes së mirë.

Përkundër kritikave ndaj ish Qeverive dhe premtimit se nuk do të ketë ministra me aktakuza, kësaj dukurie nuk i ka shpëtuar as Qeveria e udhëhequr nga LVV dhe as Kuvendi. Kjo duke dëshmuar mungesë të vullnetit për dekriminalizim të politikës, thyerje të premtimeve publike dhe cenim të besimit të publikut në institucionet qeverisëse. Skenat kur Ministra të akuzuar për korrupsion, duke

³ UNCAC, 30.6.

⁴ Po aty, neni 30.7.

⁵ “*Qeverisja me duar të pastërta (Raport mbi deputetët, ministrat dhe kryetarët e komunave të cilët kanë probleme me ligjin)*. Fq. 6. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë. Dhjetor 2022. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2022/12/Final-Raporti-Qeverisja-me-duar-te-pasterta-2022-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 11 dhjetor 2024).

përdorur resurset shtetërore, kanë shkuar në Gjykatë për tu përballur me aktakuzat për korrupsion kanë vazhduar.

3. Deputetët dhe qeveritarët që kanë probleme me ligjin

Përkundër rëndësisë që Qeveria dhe Kuvendi mos të përbëhen nga persona të cilët kanë probleme me ligjin dhe përkundër zotimeve të partisë tani në pushtet se kjo nuk do të ndodhë, kjo dukuri ka vazhduar të ndodhë edhe në Qeverisjen aktuale.

a. Kuvendi

Kuvendi i Republikës së Kosovës vazhdon të përbëhet nga deputetë të cilët kanë probleme me ligjin. Sipas të dhënave nga monitorimi i IKD, nga 120 deputetë, tetë prej tyre kanë raste aktive në gjykata derisa një deputete ka dënim të formës së prerë. Shprehur në përqindje, 7.5% e deputetëve të Kuvendit janë persona të cilët kanë probleme me Ligjin.

Pjesa më e madhe e deputetëve që kanë raste aktive, apo pesë prej tyre, i takojnë Grupit Parlamentar të LVV-së, dy i takojnë atij të AAK-së, si dhe njëra deputete që këtë vit ka kaluar nga LVV në LDK.

Në këto 11 raste aktive, përfshihen 11 vepra penale me të cilat përballen këta tetë deputetë. Prej tyre, vepra penale më e shpeshtë del të jetë “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, konkretisht tetë herë. Më pas, në dy raste kemi të bëjmë edhe me vepra penale të natyrës korruptive, specifiktisht keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Ndërkaq, vepra penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” është e paraqitur në një rast.

Emri	Grupi Parlamentar	Numri i rasteve aktive	Vepra penale
Glauk Konjufca	LVV	2	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm
			Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm
Valon Ramadani	LVV	1	Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm
Jetmire Vrenezi	LVV	1	Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar
Salih Zyba	LVV	1	Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm

Fitore Pacolli – Dalipi	LVV	1	Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm
Pal Lekaj	AAK	3	Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar
			Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm
			Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm
Time Kadrijaj	AAK	1	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve
Drita Millaku	LVV – LDK	1	Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm

Tabela 1: Deputetët me aktakzua aktive.

Sa i përket deputetit Valon Ramadani, sipas monitorimit të IKD, vepra penale “Pengim i personit zyrtar, në kryerjen e detyrës zyrtare” tashmë veçse ka arritur parashkrimin në mars të këtij viti. Ndonëse për një gjë të tillë gjatë seancave të mbajtura të cilat janë monitoruar nga IKD, Gjykata nuk ka njoftuar nëse është marrë ndonjë vendim. Seanca e fundit që është mbajtur është ajo në shkurt të këtij viti⁶. Kurse, seanca e caktuar për muajin mars kishte dështuar të mbahej⁷.

Në anën tjetër, përpos aktakuzave aktive, në Kuvendin e Republikës së Kosovës ka edhe deputetë të cilët kanë aktgjykime të formës së prerë. Këtu bënë pjesë deputetja Samra Ilijaz⁸, e cila është e dënuar për mos raportim të pasurisë, vepër penale kjo pjesë e kapitullit të veprave penale të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare.

b. Qeveria

Përkundër premtimeve, Qeveria e Republikës së Kosovës në përbërjen e saj ka një sërë ministra të cilët kanë probleme me ligjin. Këtu madje bëjnë pjesë edhe të akuzuar dhe të dënuar për vepra penale nga kapitulli i korrupsionit, të cilët ushtrojnë pozicionin e ministrit në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

⁶ “Deputeti Ramadani deklarohet sërish i pafajshëm, shtyhet seanca pasi mbrojtja ishte pa shkresa të lëndës”. Betimi për Drejtësi. 23 shkurt 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-ramadani-deklarohet-serish-i-pafajshem-shtyhet-seanca-pasi-mbrojtja-ishte-pa-shkresa-te-lendes/>). (Qasur për herë të fundit më 20 nëntor 2024).

⁷ “Gjykatësja në pushim shëndetësor, shtyhet gjykimi ndaj deputetit Valon Ramadani për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend”. Betimi për Drejtësi; 5 mars 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesja-ne-pushim-shendetesor-shtyhet-gjykimi-ndaj-deputetit-valon-ramadani-per-hedhje-te-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 20 nëntor 2024).

⁸ “Ish-këshilltarja e Komunës së Prizrenit dënohet me 200 euro gjobë për mosraportim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 8 shkurt 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-keshilltarja-e-komunes-se-prizrenit-denohet-me-200-euro-gjobe-per-mosraportim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 20 nëntor 2024).

Aktualisht, sipas të dhënave të monitorimit të IKD, Qeveria përbëhet nga gjashtë persona, (pesë ministra dhe kryeministri) të cilët kanë pasur ose kanë probleme me ligjin. Shprehur në përqindje, i bie se 37.5% e Qeverisë përbëhet nga persona të cilët kanë probleme me ligjin.

Katër ministra të Qeverisë kanë raste aktive në Gjykatë, përfshirë këtu edhe raste që kanë të bëjnë me vepra penale nga kapitulli i korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare.

Emri	Pozita	Vepra penale
Xhelal Sveçla	Ministër – MPB	Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm
Arbërie Nagavci	Ministre – MASHT	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve
Albulena Haxhiu	Ministre – MD	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve
Donika Gërvalla	Ministre – MPJD	Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare ⁹

Tabela 2: Ministrat me aktakuza aktive.

Po ashtu, në Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës ka persona të cilët kishin dënime të formës së prerë. Këtu bënë pjesë kreu i Qeverisë i cili së bashku me Ministren e Drejtësisë, në vitin 2018, ishin dënuar për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm dhe për pengim të personit zyrtar. Për shkak të këtyre dënimeve, Kurti dhe Haxhiu nuk ishin certifikuar nga KQZ për të kandiduar në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021. Ndërsa, në vitin 2022, Ministria Rozeta Hajdari është dënuar për “Mosraportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare” vepër penale kjo nga nga kapitulli i korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare.

⁹ Shënim: ‘Rasti i ministres Gërvalla është i natyrës korruptive, konkretisht akuzohet për kryerjen e veprës penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”. Nga gjykata e shkallës së parë e njëjta u lirua nga përgjegjësia penale, por që gjykata konstatoi se e njëjta ka kryer vetëm kundërvajtje, me arsyetimin se pasuria të cilën nuk e ka deklaruar e njëjta, ka qenë e fituar në mënyrë të ligjshme.

Emri	Pozita	Kur është dënuar	Vepra penale	Dënimi
Albin Kurti	Kryeministër	2018	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm;	Unik: 1 vjet e 6 muaj burgim me kusht
			Pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare	
Albulena Haxhiu	Ministre – Ministria e Drejtësisë	2018	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm;	Unik: 1 vit e 3 muaj burgim me kusht
			Pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare	
Rozeta Hajdari	Ministre – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	2022	Mosraportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare	700 euro dënim me gjobë

Tabela 3. Qeveritarët me dënime të formës së prerë.

4. Qeverisja anti-korrupsion

Ndër temat kryesore gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e vitit 2021 ishte luftimi i korrupsionit. Rezultatet e pamjaftueshme në këtë fushë, skandalet e ndryshme dhe vlerësimet e vazhdueshme negative e bënë luftimin e korrupsionit të profilit të lartë prioritetin më të lartë. Luftimi i korrupsionit u gërrit në nivelin e një nevoje të patejkalueshme shoqërore.

Me premtimin për luftimin e korrupsionit, Qeveria aktuale fitoi shumicën absolute të votave, një shumicë kjo e paarritur asnjëherë më parë në Kosovën e pasluftës. Programi zgjedhor i partisë në pushtet theksonte se “Qeveria jonë do të dëshmojë përkushtim në luftën ndaj krimit të organizuar

dhe korrupsionit...”. Përmes këtij programi, premtohet përkrashje dhe fuqizim për sistemin e drejtësisë¹⁰.

Pas formimit të Qeverisë, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Programin Qeverisës së Republikës së Kosovës 2021-2025. Ndër të tjera, Qeveria në këtë program theksonte se “...do të fokusohemi në luftimin e krimit e korrupsionit...”, “do ta luftojmë pa kompromis krimin e organizuar e korrupsionin¹¹.

Përtej premtimeve të Qeverisë, “qeverisja anti-korrupsion” është një prej qëllimeve kryesore të Qeverisjes së Mirë. Ky qëllim manifestohet përmes parimeve të ndryshme që përmbanë koncepti i Qeverisjes së Mirë¹². Në kuptim të qeverisjes së mirë, llogaridhënia para publikut për çështje me interes publik, përfshirë edhe çështjet që ndërlidhen me korrupsionin, është e një rëndësie të veçantë.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit përcakton se “Çdo Shtet Palë duhet, në përputhje me parimet themelore të sistemit të tij ligjor, të zhvillojë dhe zbaton, ose të mbajë politika efektive dhe të koordinuara kundër korrupsionit që promovojnë pjesëmarrjen e shoqërisë dhe reflektojnë parimet e sundimit të ligjit, menaxhimit të duhur të çështjeve publike dhe pronës publike, integritetit, transparencës dhe llogaridhënies”¹³. Kështu, sipas kësaj konvente, në rastin tonë Qeveria, duhet të marrë dhe zbatojë masa dhe politika kundër korrupsionit dhe, ndër të tjera, duhet të promovojë luftimin e korrupsionit.

Në kuptim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, standardet e qeverisjes së mirë materializohen nëse Qeveria nuk e cilëson veten si immune ndaj korrupsionit, por angazhohet aktivisht për të parandaluar korrupsionin brenda saj. Në kuptim të parimeve të Qeverisjes së mirë, Qeveria duhet të bashkëpunojë me institucionet e sistemit të drejtësisë në rastet e dyshimeve për korrupsion qeveritar dhe, për aq sa nuk dëmtohen hetimet, të jap llogari publike për dyshimet e ngritura. Në këtë kontekst, përfshihet edhe nevoja për ndërmarrjen e masave të përshtatshme ndaj dyshimeve të ngritura. Sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, në rastet kur një zyrtarë publik, në rastin tonë një akterë qeveritarë, akuzohet për korrupsion, ai duhet të shkarkohet, pezullohet ose rëmërohet. Kuptohet, duke u respektuar parimi i prezumimit të pafajësisë¹⁴.

¹⁰ “Prioritet për krejt qytetarët drejt së ardhmes”. Fq. 27-28; LVV. Shkurt 2021; (Shih linkun: <https://www.vetevendosje.org/ep-content/uploads/2024/08/Prioritetet-per-KREJT-qytetaret-Drejt-se-ardhmes.pdf>);

¹¹ <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf> f.5 dhe 12.

¹² “Knowledge tools for academics and professionals - UNODC Module Series on Anti-Corruption - MODULE 2 CORRUPTION AND GOOD GOVERNANCE”; fq. 10; United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC); Vienë; (Shih linkun: https://grace.unodc.org/grace/uploads/documents/academics/Anti-Corruption_Module_2_Corruption_and_Good_Governance.pdf);

¹³ Uncac, 5.1.

¹⁴ Uncac 30.6.

Në rastet kur institucionet e sistemit të drejtësisë fillojnë hetime apo ngrisin akuza për korrupsion nga akterët qeveritarë, sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsion, Qeveria duhet të bashkëpunojë me institucionet e sistemit të drejtësisë. Ky bashkëpunim përfshinë: informimin e institucioneve në rastet e dyshimeve për korrupsion dhe përgjigjen në kërkesat e institucioneve të sistemit të drejtësisë për qasje në të gjitha informacionet e nevojshme¹⁵.

Me qëllim të fuqizimit të luftës kundër korrupsion, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsion kërkon vendosjen e masave për mbrojtjen e personave që raportojnë korrupsionin¹⁶. Për këtë qëllim, Kosova tanimë ka miratuar Ligjin Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve derisa hakmarrjen për shkak të raportimit e ka përcaktuar si vepër penale¹⁷.

Përfundimisht, “qeverisja anti-korrupsion” tërheq pas vetës nevojën që Qeveria në mënyrë proaktive të promovojë dhe të marrë masa për parandalimin e korrupsionit. Kjo përfshinë raportimin e rasteve të korrupsionit, bashkëpunimin dhe institucionet e sistemit të drejtësisë në rastet e dyshimeve për korrupsion dhe dhënien e përgjegjësisë publike, për aq sa nuk dëmtohet procesin i hetimeve, në rastet kur ngriten dyshime për korrupsion ndaj Qeverisë.

Në trajtimin e rasteve të korrupsionit, Qeveria duhet të kufizohet në dyshimet për korrupsion, duke i lënë të lira dhe jashtë presionit institucionet e sistemit të drejtësisë në trajtimin e këtyre dyshimeve. Rekomandimi i Këshillit të Evropës mbi pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve thekson se pavarësia e gjyqësorit shtrihet aq gjërë sa të ndaloj kritikën e ekzekutivit dhe legjislativit mbi vendimet e marra. Përgjithësisht, dy pushtetet mund të komentojnë vendimet gjyqësore, duke i'u përmbajtur kritikave që mund të ndikojë në pavarësinë apo besimin e publikut në gjyqësor. Gjithashtu, këto dy pushtete duhet përmbajtur veprimeve të cilat vënë në pikëpyetje gatishmërinë e tyre për të respektuar vendimet gjyqësore¹⁸.

Shmangia nga komentet kritike nga politikanët kërkohet edhe nga Këshilli Konsultativ i gjyqtarëve evropianë, duke shtuar se, pushteti ekzekutiv nuk duhet të inkurajojë mos bindje ndaj vendimeve gjyqësore apo dhunë ndaj gjyqtarëve. Veprime të tilla mund të shkaktojnë ndikim të pahijshëm, presion, nxitje apo dhe ndërhyrje direkte ose indirekte¹⁹. Thjesht, pavarësia e gjyqësorit nënkupton

¹⁵ Uncac, neni 38.

¹⁶ Uncac, neni 33.

¹⁷ Kodi Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 388, paragrafi 2.

¹⁸ Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë; Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 17 nëntor 2010 në mbledhjen e 1098-të të Deputetëve të Ministrave; (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/5465AA99-CC26-4DF5-A0CC-71859B61FED3.pdf>)

¹⁹ Rekomandimi (94)12 ofron (Parimin I.2.d) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë

lirinë nga presioni i jashtëm dhe mungesa e ndikimit apo manipulimit politik, veçanërisht nga ekzekutivi²⁰.

5. Mbrojtja qeveritare e të dyshuarve për korrupsion

Përkundër faktit se në rastet e ngritjes së dyshimeve për korrupsion, nga një Qeveri anti-korrupsion kërkohet që të promovojë luftimin e korrupsionit, të bashkëpunojë me institucionet e sistemit të drejtësisë, të mbrojë sinjalizuesit, të jetë llogaridhënëse para publikut dhe të respektojë pavarësinë e gjyqësorit, IKD ka gjetur se Qeveria e Republikës së Kosovës në shumë raste ka shkelur këto parime. Përballë rëndësisë kruciale të zbatimit të këtyre parimeve, Qeveria e Republikës së Kosovës në shumë raste vepron të kundërtën: Ajo mbrojt personat e vënë nën dyshime, duke akuzuar sistemin e drejtësisë dhe akterët e tjerë. Kjo situatë paraqet të kundërtën e një qeverisje anti-korrupsion, duke dërguar një mesazh negativ sa i përket luftës kundër korrupsionit qeveritar.

a. Rezervat shtetërore

Në gusht të vitit 2023, kishin filluar arrestimet e personave të dyshuar për dallavere në lidhje me rezervat shtetërore, ku me datën 18, ishin arrestuar tre persona.²¹ Në mesin e të arrestuarve ishin dy zyrtarë të MINT, , si dhe një biznesmen. Po të njëjtën ditë, Policia kishte nisur bastisjet në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe në pronat, biznesin familjar dhe banesën e të dyshuarit Muharremi pronat e njërit prej të dyshuarve²².

Sipas dosjes së PSRK, pavarësisht se janë paguar paratë te kompanitë turke e polake për grurë, vaj e sheqer në Kosovë nuk kanë ardhur kurrë 200 mijë litra vaj, 120 mijë kg sheqer dhe 52.5 tonë grurë. Për këtë mall, në dosjen e Prokurorisë thuhej se vlera e tij ishte mbi 600 mijë euro.²³

Përballë dyshimeve për korrupsion lidhur me rezervat shtetërore, ministrja e MINT, Rozeta Hajdari, nuk bëri përpjekje për të bashkëpunuar me institucionet e sistemit të drejtësisë në drejtim të zbardhjes së rastit. Përkundrazi, pa asnjë bazë ligjore²⁴, gjatë një konference për media, ajo

²⁰ “Rule of Law Checklist”. Miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 106-të. Venecia. 11-12 mars 2016. (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)007-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)007-e)). (Qasur për herë të fundit më 20 nëntor 2024).

²¹ “Tre të arrestuar për dallavere me rezerva shtetërore, në pranga edhe Ridvan Muharremi”. Betimi për Drejtësi. 18 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/tre-te-arrestuar-per-dallavere-me-rezerva-shteterore-ne-pranga-edhe-ridvan-muharremi/>). (Qasur për herë të fundit më 20 nëntor 2024).

²² Po aty.

²³ “Ekskluzive, dosja e Prokurorisë: 52.5 tonë grurë, 200 mijë litra vaj dhe 120 mijë kg sheqer në vlerë mbi 600 mijë euro nuk erdhën në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 19 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-dosja-e-prokurorise-52-5-tone-grure-200-mije-litra-vaj-dhe-120-mije-kg-sheqer-ne-vlere-mbi-600-mije-euro-nuk-erdhen-ne-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 20 nëntor 2024).

²⁴ “Gzim Shala nga IKD-ja shpjegon situatën kur një dokument i klasifikuar mund të konfiskohet në procedurë penale”. Betimi për Drejtësi. 18 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gzim-shala-nga-ikd-ja>

akuzoj Policinë se dokumentet për rezervat shtetërore i kishte konfiskuar në mënyrë të kundërligjshme, duke rrezikuar sigurinë kombëtare.²⁵

Akuzimi i Policisë së Kosovës nga Ministrja Hajdari nuk ishte veprimi i fundit pengues drejt zbardhjes së këtij rasti. Pas këtyre ngjarjeve, nga Kryeministri Albin Kurti dhe anëtarë tjerë të partisë në pushtet, pasuan sulme në drejtim të sistemit të drejtësisë.²⁶

Ministrja Hajdari, me 15 prill 2024, ishte ftuar nga PSRK për tu intervistuar në cilësi të të dyshuarës, nën dyshimin se ka kryer veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, lidhur me rezervat shtetërore. Mirëpo, sipas njoftimit të PSRK, e njëjta nuk ishte deklaruar atë ditë, duke shfrytëzuar të drejtën për tu mbrojtur në heshtje”.²⁷ Këtij njoftimi të PSRK i kishte reaguar mbrojtja e ministres Hajdari, duke e quajtur si të pasaktë. Sipas mbrojtjes, Hajdari kishte qenë e hapur për çdo pyetje të Prokurorisë por se paraprakisht kishin kërkuar që të sqarohen disa rrethana lidhur me dokumentacionin përkatës dhe se pas atij sqarimi do të ktheheshin që e dyshuara Hajdari të përgjigjet në të gjitha pyetjet e PSRK.²⁸

Ndërkaq, puna e PSRK u vazhduar të komentohej edhe më tej nga ministra, zëvendësministër, e deputet të partisë në pushtet.²⁹ Sulmet ndaj Prokurorisë kishin vazhduar edhe më vonë nga Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.³⁰

[shpjegon-situaten-kur-nje-dokument-i-klasifikuar-mund-te-konfiskohet-ne-procedure-penale/](#)). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

²⁵ “Ministrja akuzon Policinë se mori kundërligjshëm dokumentet për dallaveret me rezervat shtetërore”. Betimi për Drejtësi. 18 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ministrja-akuzon-policine-se-mori-kunderligjshem-dokumentet-per-dallaveret-me-rezervat-shteterore/>). (Qasur për herë të fundit më 20 nëntor 2024).

²⁶ “Kurti thotë se s’ka korrupsion e keqpërdorime me rezervat, përmend prokurorët e elitës së vjetër të korrumpuar”, Betimi për Drejtësi. 18 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kurti-thote-se-ska-korrupsion-e-keqperdorime-me-rezervat-permend-prokuroret-e-elites-se-vjeter-te-korrumpuar/>). “Murati thotë se sistemi i kapur i drejtësisë po bën spektakle, përmend prokurorin Milot Krasniqin se nuk bëri asgjë për ta hetuar një ish-ministër”, Betimi për Drejtësi. 19 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/murati-thote-se-sistemi-i-kapur-i-drejtjesise-po-ben-spektakle-permend-prokurorin-milot-krasnigin-se-nuk-beri-asgje-per-ta-hetuar-nje-ish-minister/>). “Pas Kurtit e Muratit, edhe deputeti i VV-së me akuzat se sistemi i drejtësisë është në shërbim të opozitës dhe milionerëve”. Betimi për Drejtësi. 19 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kurtit-e-muratit-edhe-deputeti-i-vv-se-me-akuzat-se-sistemi-i-drejtjesise-eshte-ne-sherbim-te-opozites-dhe-milionereve/>). (Qasur për herë të fundit më 20 nëntor 2024).

²⁷ “Prokuroria: Hajdari u ftua të intervistohet në cilësinë e të pandehurës, u mbrojt në heshtje”. Betimi për Drejtësi. 15 prill 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-hajdari-u-ftua-te-intervistohet-ne-cilesine-e-te-pandehures-u-mbrojt-ne-heshtje/>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

²⁸ “Avokati i Hajdarit i reagon Prokurorisë: Ministrja ishte e hapur për çdo pyetje, por kërkuam të sqarohen disa rrethana lidhur me dokumentacionin”. Betimi për Drejtësi. 15 prill 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/avokati-i-hajdarit-i-reagon-prokurorise-ministrja-ishte-e-hapur-per-cdo-pyetje-por-kerkuam-te-sqarohen-disa-rrethana-lidhur-me-dokumentacionin/>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

²⁹ “Edhe Murati e Haxhiu me akuzat ndaj Prokurorisë Speciale”. Betimi për Drejtësi, 20 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/edhe-murati-e-haxhiu-me-akuzat-ndaj-prokurorise-speciale/>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

³⁰ “Vazhdojnë sulmet e pushtetit ndaj Prokurorisë Speciale, ministrja e Drejtësisë pyet se për kënd po punon ky institucion”. Betimi për Drejtësi, 24 gusht 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/vazhdojne-sulmet-e>

Sa i përket këtij rasti, me 21 shtator 2023, Kuvendi kishte themeluar Komisionin Hetimor për Rezervat Shtetërore, për të hetuar mënyrën se si ishin blerë rezervat shtetërore. Pro themelimit të këtij Komisioni kishin votuar 69 deputetë, gjashtë deputetë kishin abstenuar dhe një deputet kishte votuar kundër.³¹ Ky Komision ishte injoruar vazhdimisht nga partia në pushtet, duke rezultuar me dështim të konstituimit të të njëjtit. Konstituimi i këtij Komisioni dështoi shtatë herë³², të gjitha këto për shkak të mungesës së deputetëve të partisë në pushtet. Konkretisht, me 4 tetor 2023³³, pasi në sallë kishin qenë të pranishëm vetëm deputetë të opozitës, mbledhja kishte dështuar dhe ishte vendosur që të mbahet në pasditën e asaj date.³⁴ Mirëpo, deputetët e partisë në pushtet nuk kishin marrë pjesë as në atë takim. Njëjtë kishte ndodhur edhe me mbledhjen e caktuar me 10 tetor 2023.³⁵

Kjo situatë do të përmendej edhe nga raporti i Transparency international, i cili theksoi se “megjithatë, ndërhyrja e vazhdueshme e Qeverisë në punën e gjyqësorit, e ilustruar me shkarkimin e kreut të njësisë së posaçme hetimore të policisë, së bashku me pengesat e deputetëve të shumicës për një hetim parlamentar mbi një rast të dyshuar të korrupsionit të madh, sugjerojnë se vullneti politik për të hequr dorë nga kontrolli dhe për të forcuar mbikëqyrjen e pavarur ende mungon”³⁶.

Përpos mungesës së bashkëpunimit me institucionet e sistemit të drejtësisë, krijimin e pengesave për krijimin e komisionit hetimor parlamentar dhe përmendjes së këtij rasti nga rasti i Transparency International, Qeveria dërgoj mesazh negativ edhe në raport me akterët e përfshirë në këtë rast. Kjo duke iu hakmarrë sinjalizuesit dhe duke krijuar përceptimin e shpërblimit të njërit prej personave të arrestuar në këtë rast.

[pushtetit-ndaj-prokurorise-speciale-ministrja-e-drejtësisë-pyet-se-per-kend-po-punon-ky-institucion/](#)). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

³¹ “69 deputetë votojnë pro, themelohet Komisioni Hetimor për Rezervat Shtetërore”. Betimi për Drejtësi. 21 shtator 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/69-deputete-votojne-pro-themelohet-komisioni-hetimor-per-rezervat-shteterore/>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

³² <https://www.koha.net/arberi/pas-shtate-deshtimesh-konstituohet-komisioni-hetimor-per-rezervat-shteterore>

³³ “Mungojnë deputetët e Vetëvendosjes, nuk konstituohet Komisioni Hetimor për rezervat”. Betimi për Drejtësi, 4 tetor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-deputetet-e-vetevendosjes-nuk-konstituohet-komisioni-hetimor-per-rezervat/>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

³⁴ “Deputetët e VV-së s’ marrin pjesë as në takimin e pasdites, shtyhet mbledhja për konstituimin e Komisionit Hetimor”. Betimi për Drejtësi, 4 tetor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deputete%cc%88-e-vv-se%cc%88-smarrin-pjese%cc%88-as-ne%cc%88-takimin-e-pasdites-shtyhet-mbledhja-pe%cc%88r-konstituimin-e-komisionit-hetimor/>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

³⁵ “Për herë të tretë, dështon konstituimi i Komisionit Hetimor për rezerva shtetërore”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/per-herë-te-trete-deshton-konstituimi-i-komisionit-hetimor-per-rezerva-shteterore/>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

³⁶ “CPI 2023 for Eastern Europe & Central Asia: Autocracy & weak justice systems enabling widespread corruption”. Transparency International. 30 janar 2024. (Shih linkun: <https://www.transparency.org/en/news/cpi-2023-eastern-europe-central-asia-autocracy-weak-justice-systems-widespread-enabling-corruption>). (Qasur për herë të fundit më 21 nëntor 2024).

Njëri prej të arrestuarve në këtë rast ishte Irfan Lipovica, i cili dyshohet se kishte keqpërdorur detyrën si zëvendës sekretar i përgjithshëm³⁷. Tani, në faqen zyrtare të MINT, figuron se i njëjti mbanë pozitën e zëvendësuesit të drejtorit të përgjithshëm në Drejtorinë e Akreditimit të Kosovës³⁸. Për më tepër, në media u raportua se në bazë të njoftimit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MINT-it, i njëjti është kualifikuar për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Akreditimit³⁹. Po ashtu, ishte publikuar edhe njoftimi për renditjen përfundimtare të kandidatëve⁴⁰.

Në anën tjetër, fat të njëjtë me Lipovicën nuk pati Ermal Kutllovci, i cili kishte sinjalizuar dyshimet e tij në lidhje me çështjen e rezervave shtetërore. Kutllovci ishte larguar nga puna, veprim të cilin e konsideron se hakmarrje ndaj tij për shkak të sinjalizimit të bërë. Sipas tij, ndëshkimi disiplinor i'u ishte bërë për shkak të ngritjes së zërit kritik brenda institucionit⁴¹. I njëjti në postimin e tij ku e kishte bërë të ditur largimin e tij nga puna, kishte publikuar edhe vendimin për largimin nga shërbimi civil⁴².

Kryesisht, në vendimin për largimin e tij nga puna, mes tjerash potencohet se i njëjti e ka tejkaluar hierarkinë, duke dërguar shkresë tek kryeministri Albin Kurti, ministrja Hajdari dhe zyrtarëve të tjerë të kabinetit qeveritar⁴³. Përmes një reagimi, MINT kishte thënë se largimi nga puna Kutllovcit dhe një zyrtari tjetër ishte bërë pas shkeljeve të rënda të detyrave dhe përgjegjësive të punës, duke theksuar se të njëjtit kishin shpërndarë lajme të pavërteta ndaj MINT⁴⁴.

Ligji Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i ofron sinjalizuesve mbrojtje nga veprimet e dëmshme që mund të jenë si hakmarrje ndaj tyre nga punëdhënësi. Ky ligj synon që të mbrojtë nga hakmarrja dhe veprimet e tjera të dëmshme personat të cilët raportojnë keqbërje të caktuara. Respektimi dhe madje promovimi i zbatimit të këtij Ligji është çështjet kryesore në fushën e luftimit të korrupsionit. Megjithatë, në këtë situatë, përgjegjësia i takon edhe Prokurorit të Shtetit

³⁷ “Ekskluzive, dosja e Prokurorisë: 52.5 tonë grurë, 200 mijë litra vaj dhe 120 mijë kg sheqer në vlerë mbi 600 mijë euro nuk erdhën në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 19 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-dosja-e-prokurorise-52-5-tone-grure-200-mije-litra-vaj-dhe-120-mije-kg-sheqer-ne-vlere-mbi-600-mije-euro-nuk-erdhen-ne-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2024).

³⁸ Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës. Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. (Shih linkun: <https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1.61>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2024).

³⁹ “Rozeta Hajdari e shpërblen me pozitë të lartë të arrestuarin për vjedhje të Rezervave Shtetërore”. Periskopi. 22 nëntor 2024. (Shih linkun: <https://www.periskopi.com/rozeta-hajdari-e-shperblen-me-pozite-te-larte-te-arrestuarin-per-vjedhje-te-rezervave-shteterore/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2024).

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ “Largohet nga puna sinjalizuesi i MINT-it, thotë se kjo është hakmarrje për çështjen e rezervave shtetërore”. Betimi për Drejtësi. 30 janar 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/largohet-nga-puna-sinjalizuesi-i-mint-it-thote-se-kjo-esh-te-hakmarrje-per-ceshtjen-e-rezervave-shteterore/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2024).

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ “MINT thotë se largimi i dy zyrtarëve nga puna u bë për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave”. Betimi për Drejtësi. 3 shkurt 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mint-thote-se-largimi-i-dy-zyrtareve-nga-puna-u-be-per-shkak-te-shkeljeve-te-renda-te-detyrave/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2024).

për mos veprim. Kjo për shkak se sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, hakmarrja ndaj sinjalizuesve është vepër penale⁴⁵, për inicimin e të cilit rast, Prokurori i Shtetit nuk ka njoftuar opinionin publik.

Kështu, tek opinioni publik, është dërguar mesazhi se njëri prej personave të arrestuar për keqpërdorime në rastin në lidhje me rezervat shtetërore është avancuar në detyrë derisa nga detyra është shkarkuar zyrtari i cila ka sinjalizuar dyshimet e tij për keqbërje në këtë proces.

Kjo qasje e ndjekur nga Qeveria në këtë rast dëshmon një qasje negative në kuptim të luftës qeveritare të korrupsionit. Sipas standardeve të mira ndërkombëtare, në gjithë këtë situatë, Qeveria do të duhej të bashkëpunonte me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe ti suportonte ato në drejtim të zbardhjes së rastit. Kuptohet, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Në fakt, këtu ndodhi e kundërta: Qeveria u mobilizua për ti dalë kundër organit të ndjekjes, madje duke e akuzuar pa asnjë bazë Policinë e Kosovës, për provat që kishte mbledhur në këtë rast. Qeveria dërgoj mesazh të shpërblimit për personat e përfshirë në këtë rast dhe të hakmarrjes për personat që kishin sinjalizuar dyshimet e tyre për keqpërdorim në këtë rast.

b. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)

Bastisje e arrestime për korrupsion u bënë edhe në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ministri kjo e udhëhequr nga Liburn Aliu. Madje, në procese hetimore nën dyshime për korrupsion është i përfshirë edhe vetë ministri Aliu.

Fillimisht, me 8 tetor 2024, PSRK kishte nisur një aksion në objektin e MMPHI. PSRK kishte njoftuar se në këtë Ministri po dyshohen dy persona për kryerjen e veprave penale që lidhen me keqpërdorim të detyrës zyrtare, shpëlarje parash dhe mosraportim apo raportim të rremë të pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë a detyrimeve financiare⁴⁶.

Po atë ditë, përmes një komunikate të përbashkët për media të Policisë dhe PSRK ishte bërë e ditur se në këtë aksion ishte arrestuar zëvendëssekretari i kësaj Ministrie, Izedin Bytyqi dhe Naser Hafizi. Ky i fundit nuk ishte gjetur në vendbanimin e tij⁴⁷, derisa i njejt i arrestua një ditë më vonë⁴⁸.

⁴⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Nr 06/L-074), neni 388, paragrafi 2.

⁴⁶ “Policia dhe PSRK-ja japin detaje për aksionin në MMPHI ku u arrestua zëvendëssekretari, Izedin Bytyqi”. Betimi për Drejtësi. 8 tetor 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/policia-dhe-psrk-ja-japin-detaje-per-aksionin-ne-mmphi-ku-u-arrestua-zevendesekretari-izedin-bytyqi/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2024).

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ “Arrestohet Naser Hafizi”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/arrestohet-naser-hafizi/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2024).

Ndërkaq, me 21 tetor 2024 u raportua se nën hetime është edhe vetë ministri Aliu⁴⁹, gjë për të cilën ky i fundit tha se nuk ka pasur ndonjë njoftim zyrtar⁵⁰. Në aktvendimin për zgjerimin e hetimeve theksohej se ministri Aliu kishte keqpërdorur detyrën zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vetën, apo për të tjerët dhe për ti shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës. I njëjti dyshohet se kishte qenë në dijeni për veprimet e dy të dyshuarve tjerë dhe ka lejuar t'i ulen borxhet disa operatorëve ekonomik, e ku si pasojë buxhetit të Republikës së Kosovës i ishte shkaktuar dëm në vlerë prej miliona euro⁵¹.

Më pas, në muajin nëntor, nga Qeveria pasuan sulme në drejtim të PSRK. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Hekuran Murati, e akuzoi Prokurorinë se kjo e fundit nuk është duke luftuar korrupsionin, por se është duke e luftuar Qeverinë⁵².

Në anën tjetër, PSRK iu kishte përgjigjur kësaj, duke theksuar se tendencat e akterëve të partive politike, përfshirë këtu përfaqësuesit e Qeverisë, të cilët synojnë të minojnë kredibilitetin dhe profesionalizmin e Prokurorisë Speciale, kanë qenë dhe do të jenë të dështuara⁵³. Po ashtu, në këtë reagim ishte theksuar edhe se KPK-ja dhe ZKPSH-ja mbështesin Prokurorinë Speciale në ushtrimin e funksioneve të saj, përkatësisht në luftën e pakompromis ndaj të gjitha veprave penale që kjo prokurori i ka në kompetencë⁵⁴.

Pra, në një rast ku dyshohet për korrupsion, e si rezultat i të cilit, buxhetit të Republikës së Kosovës iu shkaktua dëm në vlerë prej miliona euro, Qeveria vazhdon të ofrojë mbrojtje personave nën procese hetimore, duke sulmuar institucionet e sundimit të ligjit.

c. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Përkundër dyshimeve e akuzave të shumta, mbrojtje qeveritare gëzoi edhe Nagip Krasniqi. I njëjti kishte qenë drejtues i Komitetit për Energji në Lëvizjen Vetëvendosje, kurse në tetor të vitit 2021

⁴⁹ “Aliu: S’kam marrë njoftim zyrtar se kanë nisur hetime ndaj meje, jam i gatshëm të bashkëpunoj për drejtësi”. Betimi për Drejtësi. 21 tetor 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aliu-skam-marre-njoftim-zyrtar-se-kane-nisur-hetime-ndaj-meje-jam-i-gatshem-te-bashkepunoj-per-drejtesi/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2024).

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ “EKSKLUZIVE: Liburn Aliu dyshohet se i shkaktoi dëm miliona euro shtetit, prokuroria nis hetimet”. Gazeta Nacionale. Nëntor 2024. (Shih linkun: https://nacionale.com/politike/ekskluzive-liburn-aliu-dyshohet-se-i-shkaktoidem-miliona-euro-shtetit-prokuroria-nis-hetimet?utm_source=chatgpt.com). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁵² “Murati akuzon Prokurorinë Speciale se po e lufton Kurtin dhe po ia bën argatin opozitës”. Koha. 24 nëntor 2024. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/murati-akuzon-prokurorine-speciale-se-po-e-lufton-kurtin-dhe-po-ia-ben-argatin-opozites>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁵³ “Murati e akuzoi për “luftim të Kurtit”, Prokuroria Speciale i kërkon të mos e pengojë në punë”. Koha. 25 nëntor 2024. (Shih linkun: https://www.koha.net/arberi/murati-e-akuzoi-per-luftim-te-kurtit-prokuroria-speciale-i-kerkon-te-pengoje-ne-pune?utm_source=chatgpt.com). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁵⁴ Po aty.

u bë e ditur se ishte zgjedhur si kryeshef ekzekutiv në KEK⁵⁵. Krasniqi ishte zgjedhur për këtë pozitë nga një Bord i Përkohshëm që ishte emëruar nga Qeveria Kurti⁵⁶.

Pas bastisjeve që Policia kishte kryer në KEK, në prill të vitit 2023, Krasniqi u arrestua për shkak të dyshimit se ka kryer “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Ushtrimi i ndikimit” dhe “Konflikti i interesit”⁵⁷. Njësia e Veçantë e Hetimeve kishte bastisur zyrën e Krasniqit dhe dy banesa në lokacione të ndara në Prishtinë, në pronësi dhe të shfrytëzuara nga i njëjti⁵⁸. Krasniqit iu caktua masa e paraburgimit.

Për arrestimin e tij, reagoi gjatë një seance në Kuvend edhe kryeministri Kurti. Mes tjerash, ai tha se është i bindur që në Prokurori ekziston një disponim politik negativ karshi qeverisë së tij, e që sipas tij lidhet me procesin për përzgjedhjen e kryeprokurorit të shtetit⁵⁹. Ndaj deklaratave të LVV-së, kishte reaguar edhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK). Nga këta të fundit, ato deklarata u panë si ndërhyrje flagrante në punën e Prokurorisë së Shtetit. Po ashtu, KPK e cilësoi si të pa pranueshme gjuhën e përdorur ndaj kryeprokurorit Isufaj⁶⁰.

Me 19 gusht 2024, PSRK ngriti aktakuzë ndaj Krasniqit. Sipas dosjes së Prokurorisë, ai akuzohet se KEK-ut i ka shkaktuar dëm mbi 3.2 milionë euro dhe mbi 500 mijë euro shmangie tatimore në dëm të Republikës së Kosovës⁶¹.

Kështu, përballë dyshimeve për keqpërdorime, Qeveria nuk proklamoi luftimin e korrupsionit por të kundërtën e saj, duke i ofruar mbështetje të pandehurit dhe duke sulmuar PSRK. Kjo qasje pos që paraqet shkelje të pavarësisë së sistemit të drejtësisë, në të njëjtën kohë është në kundërshtim me parimet e qeverisjes së mirë dhe parimet që një qeveri anti korrupsion duhet të ndjekë.

⁵⁵ “Zgjedhet kryeshefi ekzekutiv i KEK.sh.a”. Korporata Energjetike e Kosovës. 4 tetor 2021. (Shih linkun: <http://kek-energy.com/kek/zgjedhet-kryeshefi-ekzekutiv-i-kek-sh-a/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁵⁶ “Njeriu i Vetëvendosjes zgjidhet kryeshef i KEK-ut”. Telegrafi. 2021. (Shih linkun: <https://telegrafi.com/njeriu-vetevendosjes-zgjidhet-kryeshef-kek-ut/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁵⁷ “Arrestohet drejtori i KEK-ut, Nagip Krasniqi”. Betimi për Drejtësi. 18 prill 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/https-betimiperdrejtesi-com-wp-admin-post-phppost163001actionedit/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ “Kurti për rastin e drejtorit të KEK-ut: Arrestimi i tij e gëzoi opozitën”. Betimi për Drejtësi. 20 prill 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kurti-per-rastin-e-drejtorit-te-kek-ut-arrestimi-i-tij-e-gezoi-opoziten/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁶⁰ “KPK reagon ndaj deklaratave të LVV-së për Kryeprokurorin Isufaj: Ndërhyrje flagrante në punën e Prokurorit të Shtetit”. Betimi për Drejtësi. 20 prill 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-reagon-ndaj-deklaratave-te-lvv-se-per-kryeprokurorin-isufaj-nderhyrje-flagrante-ne-punen-e-prokurorit-te-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁶¹ “Dosja e Prokurorisë ndaj Nagip Krasniqit, mbi 3.2 milionë euro dëm për KEK-un e mbi 500 mijë euro shmangie nga tatimi”. Betimi për Drejtësi. 21 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/dosja-e-prokurorise-ndaj-nagip-krasniqit-mbi-3-2-milione-euro-dem-per-kek-un-e-mbi-500-mije-euro-shmangie-nga-tatimi/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

d. Dyshimet për kontratat një burimore

Kontratat një burimore janë procedurë një prej procedurave ligjore të prokurimit publik. Për nga mënyra se si zhvillohen këto procedura të prokurimit publik, pa publikim të njoftimit për tender, paraqet potencial të lartë korruptiv. Për këtë arsye, përdorimi i këtyre procedurave duhet të kufizohet vetëm në raste kur procedurat e tjera është e pamundur të aplikohen.

Opozita e akuzoj Qeverinë aktuale për përdorim të madh të këtyre procedurave. Ish-ministrja Hykmete Bajrami theksonte se kishte pranuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik një përgjigje, sipas të cilës nga 22 marsi i 2021-tës deri më 1 shtator të 2024-tës janë lidhur 2 mijë e 123 kontrata të tilla dhe se vlera e tyre kap shifrën e mbi 272 milionë eurove.

Rritja e numrit të këtyre kontratave vit pas viti filloi të ngre dyshime për keqpërdorime. Në fund të muajit të kaluar u raportua se prokuroria është duke hetuar mbi 1 mijë e 300 kontrata të reja një burimore të lidhura në katër vitet e fundit në Kosovë⁶².

Lidhur me këtë kishte reaguar ministri i MFPT, Hekuran Murati. Sipas tij, këto shifra përfshijnë të gjitha institucionet – qeverinë qendrore, institucionet e pavarura, komunat dhe ndërmarrjet publike⁶³. Po ashtu, i njëjti kishte deklaruar se përdorimi i këtyre shifrave duke thënë se janë qindra miliona euro e mijëra kontrata duke ia atribuuar qeverisë qendrore, është manipulim vetëm e vetëm për të krijuar përshtypjen te qytetari se kemi të bëjmë me një keqpërdorim të madh⁶⁴.

Përballë nevojës që të bashkëpunohej me institucionet e sistemit të drejtësisë, për të qartësuar këto situata, ndodhi e kundërta. Zv. Ministri i Drejtësisë, në mënyrë indirekte, e cilësoj PSRK si organizatë të përbashkët kriminale.

Zëvendësministri i Drejtësisë, Blerim Sallahu, në profilin e tij në rrjetin social “Facebook” kishte shpërndarë një postim të drejtorit të Financave në Telekomin e Kosovës, Feim Kelmendi⁶⁵. Ky postim ishte publikuar pasi Prokuroria kishte filluar hetime në lidhje me disa kontrata. Përmes këtij postimi, duke u kritikuar mënyra e veprimit, Prokuroria Speciale cilësohet si organizatë kriminale.

Një ditë pas këtij postimi, KPK dhe Zyra e Kryeprokurorit kishin reaguar ndaj Sallahut, duke thënë se cilësimi si “organizatë kriminale” e Prokurorisë krijojnë pasiguri për prokurorët dhe familjet e

⁶²“Mbi njëmijë tenderë njëburimorë raportohet se po hetohen nga Prokuroria”. Telegrafi. Nëntor 2024. (Shih linkun: https://telegrafi.com/mbi-nje-mije-tendere-njeburimore-raportohet-se-po-hetohen-ngaprokuroria/?utm_source=chatgpt.com). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ Postimi i drejtorit të Financave në Telekomin e Kosovës, Feim Kelmendi në profilin e tij në rrjetin social Facebook. 11 nëntor 2024. (Shih linkun: <https://www.facebook.com/share/p/1CjefHCVoD/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

tyre. Në reagimin e tyre, ishte potencuar se deklaratime të tilla kanë përmbajtje jashtëzakonisht nxitëse, tendencioze, propaganduese dhe linçuese ndaj kësaj prokurorie dhe prokurorëve të saj⁶⁶.

Ajo çfarë proklamoi Qeveria në këtë rast përmes zv. Ministrit Sallahu është tendenca për të penguar punën e PSRK në hetimin e dyshimeve për korrupsion qeveritar. Në situata kur institucionet e sistemit të drejtësisë kanë dyshime në lidhje me çështje të caktuara, Qeveria duhet të bashkëpunojë me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe jo të tentojë ti vë këto institucione nën presion të vendimmarrjes.

Megjithatë, kjo nuk kishte qenë hera e parë kur zëvendësministri kishte sulmuar PSRK-në. Para tri viteve Prokurorët kishin ndërprerë bashkëpunimin me Qeverinë, pasi kjo e fundit nuk ishte distancuar nga deklaratat e zëvendësministrit Sallahu, ku kishte thënë se edhe prokurorët janë të përfshirë në veprime kriminale⁶⁷.

6. Skandalet pa përgjigje

Llogaridhënia para publikut në lidhje me dyshimet e ngritura në raste të caktuara është kryesore për qeverisjen e mirë. Në rastet kur Qeveria akuzohet nga një masë e gjerë e publikut për dyshime në lidhje me keqpërdorime të caktuara, është kryesore që Qeveria të japë llogari publike në raport me këto pretendime të ngritura. Kuptohet, duke dhënë sqarime deri në nivelin që nuk cenojnë hetimet e institucioneve të tjera.

Megjithatë, deri më tani, identifikohen një sërë çështjesh kur publiku i gjerë ka pasur dyshime të theksuara në raport me çështje specifike e të cilat nuk janë adresuar në mënyrë adekuate nga ana e Qeverisë.

a. Ndërhyrjet në KEK

Një prej skandaleve gjatë kësaj qeverisje ishte edhe ndërhyrja në KEK. Këto dyshime u rritën edhe më shumë pas publikimit të mesazheve në mes të koordinatores së LVV-së, Dejana Mihali dhe kryeshefit ekzekutiv të KEK-ut, Nagip Krasniqi. Këto mesazhe shfaqnin dyshime për ndërhyrje nga një person që nuk ishte fare zyrtarë publik tek kryeshefi ekzekutiv i KEK-ut. Raportimet tregonin edhe për urdhra të Mihalit se në cilat prej ditëve nuk duhet të ketë reduktime të energjisë

⁶⁶“KPK-ja dhe ZKPSH-ja i reagojnë zëvendësministrit Sallahu për “kommentet nxitëse e tendencioze” për PSRK-në”. Betimi për Drejtësi. 12 nëntor 2024. (Shih linkun:<https://betimiperdrejtesi.com/kpk-ja-dhe-zkps-h-ja-i-reagojne-zevendesministrit-sallahu-per-komentet-nxitese-e-tendencioze-per-psrk-ne/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁶⁷“Prokurorët ndërpresin bashkëpunimin me Qeverinë: Nuk u distancuan nga deklaratat e Sallahut”. Telegrafi. (Shih linkun: <https://telegrafi.com/prokuroret-nderpresin-bashkepunimin-qeverine-nuk-u-distancuan-nga-deklaratat-e-sallahut/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

elektrike⁶⁸. Përveç këtyre ndërhyrjeve që Mihali kishte në KEK, e njëjta i kërkonte llogari kryeshefit Krasniqi për informacionet që dilnin nga KEK-u⁶⁹.

Pas këtyre, opozita doli me një projekt rezolutë duke kërkuar hetime për skandalet në KEK. Përmes kësaj projekt rezolute kërkohet hetim për ndërhyrjet e personave të paautorizuar në menaxhimin dhe vendimmarrjen në KEK, për dhënien e tenderëve, tregtinë e energjisë dhe proceset e punësimit. Përveç tjerash, kërkohet që të hetohet edhe roli dhe ndikimi i jashtëligjshëm i Dejona Mihalit në menaxhimin dhe vendimmarrjen në KEK⁷⁰.

Sidoqoftë, pozita nuk shfaqti ndonjë vullnet për të çuar në fund hetimin e kërkuar përmes asaj projekt rezolute.

Ndërkaq, Mihali u intervistua nga PSRK me 20 shtator 2024, në cilësi të dëshmitares në lidhje me disa çështje penale⁷¹.

Me 24 tetor 2024, në një seancë të jashtëzakonshme, deputetë të partive opozitare kishin shprehur shqetësim se në KEK ka keqmenaxhim e ndërhyrje të jashtëligjshme nga persona të partisë në pushtet. Kjo kishte qenë seanca e katërt e jashtëzakonshme e thirrur nga opozita për të diskutuar për skandale dhe keqmenaxhime në KEK, e cila ishte bojkotuar nga pozita. Ku as deputetët e partisë në pushtet dhe as anëtarët e kabinetit qeveritar nuk ishin përballur me akuzat.

b. Subvencionet

Subvencionet janë ndihma financiare të cilat Qeveria i ofron për të mbështetur sektorë të ndryshëm ekonomikë. Një prej sektorëve që mbështetet financiarisht nga Qeveria, është ai i bujqësisë, përmes të cilave ndihmohen fermerët.

Mirëpo mundësitë që këto fonde të keqpërdoren nga zyrtarët përgjegjës mbesin të mëdha. Prej proceseve gjyqësore më të famshme që kanë të bëjnë me vepra të natyrës korruptive janë rastet e njohura si “Subvencionet”, gjithsejtë gjashtë sosh. Në rastin “Subvencionet 1” pretendohet se buxhetit të Republikës së Kosovës i është shkaktuar dëm në vlerë prej më shumë se 600 mijë euro. Kurse në rastet e tjera pretendohet për dëme prej mijëra, dhjetëra e qindra mijëra euro. Këto raste

⁶⁸ “Mesazhet e Mihalit me Nagip Krasniqin shkaktajnë shumë reagime: Dejona paska vendosë edhe kur me na ndalë rrymën”. *Gazeta Nacionale*. Nëntor 2024. (Shih linkun: <https://nacionale.com/politike/mesazhet-e-mihalit-me-nagip-krasniqin-shkaktajne-shume-reagime-dejona-paska-vendos-edhe-kur-me-na-ndal-rrymen>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁶⁹ Po aty.

⁷⁰ “Debati për skandalet në KEK, çfarë thuhet në projektrezolutën e opozitës që përmend edhe Dejona Mihalin”. *Gazeta Express*. 23 tetor 2024. (Shih linkun: <https://www.gazetaexpress.com/debati-per-skandalet-ne-kek-cfare-thuhet-ne-projektrezoluten-e-opozites-qe-permend-edhe-dejona-mihalin/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁷¹ “Mihali thotë se ishte në Prokurorinë Speciale për të ndihmuar në zbardhjen e së vërtetës”. *Betimi për Drejtësi*. 20 shtator 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mihali-thote-se-ishte-ne-prokurorine-speciale-per-te-ndihmuar-ne-zbardhjen-e-se-vertetes/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

pretendohet se buxhetit të Republikës së Kosovës i kanë shkaktuar dëm me qindra mijëra euro, përmes veprimeve të ndryshme, si keqpërdorime, mashtrime e ryshfet. Koha e kryerjes së atyre veprave penale, kryesisht pretendohet të jetë nga gjysma e vitit 2020, e në vazhdimësi⁷².

Muajt e fundit u ngjallën dyshime se keqpërdorimet në ndarjen e këtyre mjeteve po vazhdojnë të ndodhin, e tani edhe deri në përfshirje të direkt ministrit të Bujqësisë, Faton Peci. Kjo për shkak se nga ndarja e subvencioneve dolën se kanë përfituar edhe familjarë të bashkëpartiakëve, e njerëz të afërm të tij. Dyshimet për këtë të fundit u ngritën pasi u raportua se ministria që udhëhiqet nga Peci kishte ndarë një grant prej 100 mijë euro për vëllain e deputetes të LVV-së, Fitore Pacolli. Sipas këtyre raportimeve, kontrata me firmën e tij “Alda Farm Ria”, është nënshkruar me 16 korrik, kurse firma ishte hapur vetëm katër ditë më herët, konkretisht me 12 korrik. Përveç kësaj, kjo ministri kishte ndarë edhe 100 mijë edhe për këshilltarin e ministrit Peci, Naim Huruglicën⁷³.

Pas raportimeve për grantet që u ishin ndarë vëllait të ministres Pacolli dhe këshilltarit të ministrit Peci, Ministria e Bujqësisë ka pezulluar përkohësisht procedurën administrative, deri nën marrjen e vendimit përfundimtar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me këtë çështje. Po ashtu, për të njëjtat lëndë është kërkuar edhe auditim i brendshëm⁷⁴. Gjithashtu, javë më parë kishte pasur raportime edhe se një grant prej 50 mijë euro ishte fituar nga një bashkëpartiak i tij, për një projekt për ndërtimin e tri vilave⁷⁵. Dyshimet bëhen edhe më serioze nga raportimet se që nga ardhja e ministrit Peci në këtë pozitë, më nuk vazhdojnë të publikohen emrat e përfituesve të

⁷² “Aktakuza e ndryshuar e PSRK në rastin “Subvencionet 1”. Betimi për Drejtësi. 17 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuza-e-ndryshuar-e-psrk-ne-rastin-subvencionet-1/>). “Deklarohen rreth fajësisë 15 të akuzuarit në rastin “Subvencionet II”. Betimi për Drejtësi. 13 mars 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-rreth-fajesise-15-te-akuzuarit-ne-rastin-subvencionet-ii/>). “Dosja Subvencionet 3” – akuzohen zyrtarë dhe qytetarë për marrje dhe dhënie ryshfeti të mijëra eurove”. Betimi për Drejtësi. 21 korrik 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/dosja-subvencionet-3-akuzohen-zyrtare-dhe-qytetare-per-marrje-dhe-dhenie-ryshfeti-te-mijera-eurove/>). “Mbahet seanca për caktimin e lartësisë së dënimit ndaj dy të akuzuarve në rastin “Subvencionet 4”. Betimi për Drejtësi. 13 mars 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mbahet-seanca-per-caktimin-e-lartesise-se-denimit-ndaj-dy-te-akuzuarve-ne-rastin-subvencionet-4/>). “Ekskluzive: Aktakuza e Prokurorisë Speciale ndaj 18 të akuzuarve në rastin “Subvencionet V”. Betimi për Drejtësi. 12 maj 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-aktakuza-e-prokurorise-speciale-ndaj-18-te-akuzuarve-ne-rastin-subvencionet-v/>). “Subvencionet 6”, 11 të akuzuar deklarohen të pafajshëm, 5 të tjerët pranojnë fajësinë”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/subvencionet-6-11-te-akuzuar-deklarohen-te-pafajshem-5-te-tjeret-pranojne-fajesine/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁷³ “Skandali me subvencione, Peci-opozitës: Kriminela, s'mund të më ndalni as me ujë e as me plumba; Reporteri. 17 nëntor 2024. (Shih linkun: <https://reporteri.net/lajme/skandali-me-subvencione-peci-opozites-kriminela-smund-te-me-ndalni-as-me-ujë-e-as-me-plumba/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁷⁴ “Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë pezullon grantet për këshilltarin e ministrit Faton Peci dhe vëllain e deputetes Fitore Pacolli”. Telegrafi. Nëntor 2024. (Shih linkun: https://telegrafi.com/agjencia-per-zhvillimin-e-bujqesise-pezullon-grantet-per-keshilltarin-e-ministrit-faton-peci-dhe-vellain-e-deputetes-fitore-pacolli/?utm_source=chatgpt.com). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁷⁵ “Faton Peci i jep bashkëpartiakut të tij mbi 50 mijë euro për ndërtimin e tri vilave”. Insajderi. 23 tetor 2024. (Shih linkun: <https://insajderi.org/faton-peci-i-jep-bashkepartiakut-te-tij-mbi-50-mije-euro-per-ndertimin-e-tri-vilave/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

granteve, por vetëm numri identifikues, e që opiniononi publik nuk mund të shoh emrat se kush është përfitues i subvencioneve⁷⁶.

Akuzat në drejtim të tij, ministri Peci i quajti shpifje të orkestruara nga partitë opozitare, duke mohuar se ministria ka ushtruar ndikim në ndarjen e atyre fondeve⁷⁷. Ministri Peci mohoi që dikush të jetë diskriminuar në këtë proces, por sipas tij të gjithë janë trajtuar në mënyrë meritore⁷⁸. Nga opozita u kërkua shkarkimi i tij dhe i Fitore Pacollit⁷⁹.

c. Ambasadori Berishaj

Prej skandaleve më të përfolura gjatë viteve të fundit është rasti i ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj. Për Berishajn fillimisht kishte të filluar të raportohej se i njëjti kishte marrë shtetësinë e Kosovës disa muaj para se të emërohej në këtë pozitë në dhjetor të viti 2021⁸⁰.

Vetëm pak muaj më pas, më 21 prill 2022, nga mediumi slloven “Planet TV” u raportua për një skandal të madh financiar ku përfshihej edhe ambasadori Berishaj, e që kishte të bënte me një aferë financiare të kryeministrit të Sllovenisë, Rober Golob⁸¹. Për këtë të fundit u tha se po hetohej ndërkombëtarisht për shkak të transaksioneve financiare. Kurse, për kompaninë e Berishajt në Mal të Zi, “MB Consulting”, u tha se ishte adresë e këtyre transaksioneve. Kurse, transaksioni thuhej se vinte nga dega serbe e furnizuesit energjetik slloven GEN-I.

Pra, për ta thjeshtësuar, i binte që Berishaj të jetë urë lidhëse për transaksionet që vinin nga dega serbe e furnizuesit energjetik slloven GEN-I, e që destinim kishin kryeministrin slloven.

⁷⁶ “Që nga ardhja e Pecit, emrat e përfituesve të granteve nuk publikohen në faqen e Ministrisë”. Periskopi, 16 nwntor 2024. (Shih linkun: <https://www.periskopi.com/qe-nga-ardhja-e-pecit-emrat-e-perfituesve-te-granteve-nuk-publikohen-ne-faqen-e-ministrise/>) (Qasur për here të fundit 3 dhjetor 2024)

⁷⁷ “Peci reagon ndaj akuzave për subvencione në bujqësi: Nuk kam ushtruar asnjë ndikim, procesi i bazuar në meritokraci”. Telegrafi. Nëntor 2024. (Shih linkun: <https://telegrafi.com/peci-reagon-ndaj-akuzave-per-subvencione-ne-bujqesi-nuk-kam-ushtruar-asnje-ndikim-procesi-bazuar-ne-meritokraci/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ “PDK kërkon shkarkimin e Fitore Pacollit dhe Faton Pecit pas skandalit të grantit prej 100 mijë eurove”. Telegrafi. Nëntor 2024. (Shih linkun: <https://telegrafi.com/pdk-kerkon-shkarkimin-e-fitore-pacollit-dhe-fatton-pecit-pas-skandalit-te-grantit-prej-100-mije-eurove/>). (Qasur për herë të fundit më 2 dhjetor 2024).

⁸⁰ “Martin Berishaj nuk kishte shtetësi kosovare, u bë pak para se të propozohej për ambasador në Kroaci (Dokumente)”. Syri. 14 dhjetor 2021. (Shih linkun: https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/325955/martin-berishaj-nuk-kishte-shtetesi-kosovare-u-be-pak-para-se-te-propozohej-per-ambasador-ne-kroaci-dokumente/?utm_source=chatgpt.com). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

⁸¹ “Thellohet skandali i Martin Berishajt, thellohen edhe hetimet – krerët e shtetit s’e lëshojnë ambasadorin”. Express. 12 janar 2023. (Shih linkun: <https://www.gazetaexpress.com/thellohet-skandali-i-martin-berishajt-thellohen-edhe-hetimet-kreret-e-shtetit-se-leshojne-ambasadorin/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

Kështu, pretendohet se përmes kësaj kompanie të tij, Berishaj i kishte marrë 600 mijë euro, të cilat edhe i kishte tërhequr në para të gatshme, duke u supozuar se këto do ti dërgonte tek kryeministri i Sllovenisë⁸².

Ndërkaq, në janar të viti 2023, mediumi “Prava” kishte bërë edhe një ndërlidhje në mes dërgesave të parave nga GEN-I në Slloveni për te filialet në Beograd dhe më pas pagesat nga Beogradi direkt për në kompaninë e Martin Berishajt⁸³.

Në këtë artikull thuhej edhe se ka disa sugjerime dhe informacione se paratë janë transferuar nga njëra prej filialeve të GEN-I jashtë vendit për fushatën zgjedhore të kryeministrit Kurti dhe se një pjesë e parave I kanë shkuar një organizate jo qeveritare⁸⁴.

Me 29 mars 2024, ambasadori Berishaj u intervistua nga PSRK me dyshimet për veprat penale ‘Shpëlarja e parave’, ‘Shmangia nga tatimi’ dhe ‘Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare’⁸⁵.

Ndërkaq, me 17 nëntor 2022, Berishaj u intervistua para Komisionit Hetimor, ku i kishte quajtur shpifje raportimet e mediave sllovene në lidhje me raportimet për shpëlarje parash. Ndërsa e kishte pranuar se kishte punuar në kompaninë GEN, e cila merret me tregtimin e energjisë elektrike⁸⁶.

Përkundër këtyre dyshimeve të përfshirjes së të njëjtit në afëra të këtij lloji, Berishaj pati mbrojtjen Qeverisë.

Zëdhënësi i Qeverisë, Përparim Kryeziu kishte reaguar në lidhje me raportimet e mediave sllovene, duke i quajtur ato si lajme të rreme⁸⁷.

Berishaj i ishte ofruar mbrojtje edhe nga kryeministri Kurti. Në lidhje me pretendimet e ngritura ndaj ambasadorit Berishaj, kryeministri Kurti e kishte përmendur se për këtë çështje kishte folur zëdhënësi i Qeverisë, Kryeziu. Ai e kishte potencuar edhe faktin se ambasadori Berishaj i ka mohuar ato pretendime. Po ashtu, kryeministri Kurti kishte thënë se janë të interesuar për

⁸² Po aty.

⁸³ “Skandali 100 milionësh: Mediumi 'Prava' shkruan se Kurti u financua me para të dyshimta, implikohet Martin Berishaj”. Paparaci. 9 janar 2023. (Shih linkun: https://paparaci.com/269918/skandali-100-milionesh-mediumi-prava-shkruan-se-kurti-u-financua-me-para-te-dyshimta-implikohet-martin-berishaj/?utm_source=chatgpt.com). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ “Prokuroria Speciale: Ambasadori Berishaj u intervistua me dyshimet për tri vepra penale”. Betimi për Drejtësi. 29 mars 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ambasadori-berishaj-u-intervisuta-nga-prokuroria-speciale-deklaratat-i-mbesin-konfidenciale/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

⁸⁶ “Martin Berishaj intervistohet para Komisionit Hetimor, i quan shpifje pretendimet për shpëlarje parash”. Betimi për Drejtësi. 17 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/martin-berishaj-intervistohet-para-komisionit-hetimor-i-quan-shpifje-pretendimet-per-shpelarje-parash/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

⁸⁷ “Qeveria i quan të rreme raportimet e medias sllovene që ndërlidhin Kurtin me aferën 100 milionësh të Berishajt”. Indeksonline. 10 janar 2023. (Shih linkun: <https://indeksonline.net/qeveria-i-quan-te-rreme-raportimet-e-medias-sllovene-qe-nderlidhin-kurtin-me-aferen-100-milioneshe-te-berishajt/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

Ilogaridhënie mbi të vërteta të dëshmuara dhe prova e jo pretendime dhe akuza⁸⁸. Kurse, Presidenca kishte njoftuar se presidentja e Republikës së Kosovës, ka kërkuar, në komunikim me Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që nga Ambasadori Berishaj të kërkohej raport me shkrim lidhur me artikullin në një medie në Slloveni dhe po ashtu që Ambasadori Berishaj të thirret në Kosovë për të sqaruar situatën⁸⁹.

Ndërkaq, krejtësisht e sigurt se ambasadori Berishaj është i pafajshëm, ishte deklaruar edhe Ministrja e MPJD, Donika Gërvalla⁹⁰. Ndërsa, kryeparlamentari Glauk Konjufca, ato raportime të mediave për skandalin financiar në Slloveni i kishte quajtur dëm kolateral⁹¹.

Kështu, përballë të gjitha këtyre dyshimeve, Qeveria nuk zgjodhi që në mënyrë adekuate dhe të faktura t'ia sqarojë këtë situatë publikut. Qeveria nuk shqyrtoi mundësinë e propozimit të Berishës për shkarkim. Ajo thjeshtë, pa prezantuar asnjë dokument para publikut, mbrojti Berishën, duke e marrë si të mirëqenë mohimin e tij për këto akuza.

d. Dyshimet ndaj Faruk Mujkës

Me 14 korrik 2023, u raportua se është arrestuar Faruk Mujka, atë kohë kryeshef ekzekutiv i Bordit të Ndërmarrjes Hidroekonomike “Ibër-Lepenci”. I njëjti kishte qenë edhe kryetar i degës së LVV në Mitrovicë⁹².

Në njoftimin e Prokurorisë thuhej se në maj të vitit 2022, PSRK kishte pranuar disa informacione, lidhur me dyshimet për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar nga dy persona, në atë kohë pjesë e strukturave udhëheqëse në Komunën e Mitrovicës⁹³. Pra, bëhej fjalë për Mujkën dhe ish-këshilltarin e ministrit të Bujqësisë, Hysen Muzilukaj, të cilët u dërguan në mbajtje për 48 orë⁹⁴.

⁸⁸ “Skandali i Martin Berishajt, si e mbrojtën Kurti, Osmani e Gërvalla ambasadorin e kallëzuar penalisht?”. Gazeta Nacionale. 2022. (Shih linkun: <https://nacionale.com/politike/skandali-i-martin-berishajt-si-e-mbrojten-kurti-osmani-e-gervalla-ambasadorin-e-kallezuar-penalisht/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

⁸⁹ Po aty.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ “Konjufca: Martin Berishaj dëm kolateral, Kryeministrin e ri slloven s’mund ta quajmë shpëlarës parash”. Gazeta Express. 28 prill 2022. (Shih linkun: <https://www.gazetaexpress.com/konjufca-martin-berishaj-dem-kolateral-kryeministrin-e-ri-slloven-smund-ta-quajme-shpelares-parash/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

⁹² “Prokuroria konfirmon raportimin e “Betimit për Drejtësi”: Është arrestuar Faruk Mujka i dyshuar për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 14 korrik 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-konfirmon-raportimin-e-betimit-per-drejtesi-eshte-arrestuar-faruk-mujka-i-dyshuar-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

⁹³ Po aty.

⁹⁴ “Dy të dyshuarit për korrupsion, Mujka dhe Muzliukaj dërgohen në mbajtje për 48 orë”. Betimi për Drejtësi. 14 korrik 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/dy-te-dyshuarit-per-korrupsion-mujka-dhe-muzliukaj-dergohen-ne-mbajtje-per-48-ore/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

Ndërkaq, gjatë bastisjes në dy lokacione, pronë e dy të dyshuarve, një njërin prej tyre ndër të tjera ishin gjetur dhe sekuestruar një shumë e të hollave prej 60 mijë euro⁹⁵.

Me 15 korrik 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte vendosur që të dyshuarit Mujka dhe Muzilukaj të mbrohen në liri⁹⁶.

Në lidhje me këtë rast, nuk kishte pasur ndonjë reagim nga ana e Qeverisë.

7. Mungesa e shkarkimeve

Me qëllim të ruajtjes së integritetit të institucionit dhe mbajtjes së besimit të publikut në institucionet publike, nga ana e zyrtarëve publik kërkohet që të bëjnë një hap prapa në rastet e dyshimeve të caktuara. Kjo situatë do ti mundësonte institucioneve të sistemit të drejtësisë që të qartësonin situatën derisa tek publiku dërgon një mesazh të fuqishëm integriteti. Përmes kësaj qasje, rastet e veçanta nuk lejojnë humbjen e besimit të publikut ndaj institucionit.

Kështu, në kuptim të qeverisjes së mirë, është shumë e rëndësishme që zyrtarët vet të largohet nga pozitat e tyre në rast të dyshimeve për keqpërdorime. Kjo në asnjë rrethanë nuk do të nënkuptonte praninë të përgjegjësisë. Përkundrazi, do të dëshmonte përgjegjshmëri të lartë, duke përçarur mesazhin se zyrtari në fjalë nuk ka se çfarë të fsheh dhe do të bëjë një hap prapa derisa situata të qartësohet.

Nëse kjo nuk ndodhë, atëherë është e rëndësishme të shqyrtohet shkarkimi apo pezullimi i përkohshëm i zyrtarëve, të cilën çështje tanimë e kemi trajtuar në këtë dokument.

Këto parime nuk u reflektuan në praktikë. Përgjatë Qeverisjes aktuale, u ngritën dyshime për keqpërdorime të ndryshme. Në asnjë prej këtyre rasteve, zyrtarët nuk vendosën të bëjnë një hap prapa deri në sqarimin e situatave. Ata nuk u shkarkuan apo pezulluan nga detyra e tyre. Përkundrazi, në shumë raste u morrën në mbrojtje nga Qeveria.

Kjo mënyrë e veprimit nga ana e institucioneve publike dhe zyrtarëve publik është në kundërshtim me synimet e qeverisjes së mirë. Në këto situatë, mos bërja e një hapi prapa nga ana e zyrtarit të caktuar rrezikon cenimin e besimit të publikut në vet institucionin, ashtu që rastet specifike nuk cenojnë besueshmërinë e publikut në vet institucionin e caktuar publik.

⁹⁵ “Prokuroria konfirmon raportimin e “Betimit për Drejtësi”: Është arrestuar Faruk Mujka i dyshuar për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 14 korrik 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-konfirmon-raportimin-e-betimit-per-drejtesi-eshte-arrestuar-faruk-mujka-i-dyshuar-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).

⁹⁶ “Dy të dyshuarit për korrupsion Mujka dhe Muzliukaj do të mbrohen në liri”. Betimi për Drejtësi. 15 korrik 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/dy-te-dyshuarit-per-korrupsion-mujka-dhe-muzliukaj-do-te-mbrohen-ne-liri/>). (Qasur për herë të fundit më 3 dhjetor 2024).